

Врз основа на член 55 став 1 од Законот за организација и работа на органите на државната управа („Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 58/00, 44/02, 82/08,167/10,51/11, 96/2019 и 110/2019) и член 22 став 1 од Законот за средно образование („Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17, 64/18 и „Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 229/2020) и член 3 од Законот за математичко-информатичка гимназија („Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 64/18), министерот за образование и наука ја донесе Наставната програма по *Албански јазик и литература* за II (втора) година математичко-информатичка гимназија.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

BYROJA PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT



Programi mësimor

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

për vitin II

Gjimnazi matematiko-informatik

Shkup, 2021

Emri i programit mësimor	Gjuhë shqipe dhe letërsi
Lloji i programit mësimor	Obligativ
Vlera e kreditit e programit mësimor	5 (pesë) ECVET kredite
Niveli i kualifikimit	Niveli IV (i katërt)
Viti mësimor	II (i dytë)
Numri i orëve javore/vjetore për realizimin e programit mësimor	3/108

<p>Qëllimet e programit mësimor</p>	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të zgjerojnë dhe të përthellojnë njohuritë për gjuhën standarde shqipe si mjet komunikimi; - të zgjidhin, të rezimojnë dhe të zbatojnë dituritë e arritura në kontestin gjuhësor përkatës; - të paraqesin hierarkinë dhe lidhshmërinë e njësive gjuhësore nga fonema deri te fjalia dhe të potencojnë rëndësinë e tyre në komunikimin gjuhësor; - të zbatojnë në të shprehurit me gojë dhe me shkrim rregullat gjuhësore dhe konstruktionet karakteristike për gjuhën standarde shqipe; - të zbatojnë shkathtësitë për analizë dhe interpretim të pavarur të veprave letrare nga autorë, epoka dhe drejtime të ndryshme; - të aftësohen që në mënyrë kritike dhe me argumente të vlerësojnë veprat letrare, situatat problemore, manifestimet shoqërore, kulturore e artistike dhe evenimentet përmes qëndrimeve dhe mendimeve vetjake.
<p>Njësia modulare e programit mësimor</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Gjuhë • Letërsi <p>Shënim: Modulet gjuhësore dhe letrare gjegjësisht përmbajtjet në të dy modulet duhet të kombinohen ndërmjet veti. Me këtë do të arrihet tërësia në raport me qëllimet e përgjithshme të lëndës si dhe arritja e rezultateve të parashikuara sipas kriterëve të dhëna. Çdo orë mësimore edhe më tutje do të ketë qëllimin e vet, i cili në do të kombinohet me përmbajtjet tanimë të mësuara nga njëri apo tjetri modul. Njëkohësisht ju sugjerojmë se orari dhe organizimi i mirë i përmbajtjeve të dhëna do të ndikon në realizimin e orëve, gjegjësisht do të ndikon në suksesin e nxënies në mësim.</p>
<p>Kushtet tekniko-materiale dhe hapësinore</p>	<p>Për arritjen e qëllimeve në lëndën mësimore Gjuhë shqipe dhe letërsi duhet që të sigurohen mjete mësimore në kabinete ose klasa, fond i librave për bibliotekë, qasje në internet, pajisje kompjuterike, LCD projektor etj. Për realizim të plotë dhe të suksesshëm të programit mësimor duhet të organizohen edhe aktivitete që e ndërrojnë vendin e realizimit të orës/orëve mësimore (institucione të kulturës, manifestime dhe festivale: letrare, teatrore dhe filmike).</p>

Normativi për kuadrin mësimor	<p>Programin mësimorë e realizojnë mësimdhënësit që kanë kryer:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fakultetin Filologjik, Grupin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe (drejtimi arsimor) VII/1 ose VIA sipas KMK dhe 240 ECTS; - Fakultetin Filozofik, Grupin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe (drejtimi arsimor) VII/1 ose VIA sipas KMK dhe 240 ECTS.
--------------------------------------	---

Njësia modulare: GJUHË				
Nr. rend	Rezultatet nga të nxënit	Përmbajtjet dhe konceptet	Veprimtaritë dhe metodat	Kriteret e vlerësimit
1.	Zhvillimi historik i gjuhës shqipe			

<p>1.1.</p>	<p>Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shpjegojë rrethanat historike të fillimeve të periudhës kombëtare të zhvillimit të gjuhës letrare shqipe; - të tregojë ndihmesën e N. Veqilharxhit dhe të K. Kristoforidhit në fushë të gjuhës letrare shqipe. 	<p>Zhvillimi i gjuhës shqipe gjatë periudhës kombëtare (etapa e parë)</p> <p>Ëvetari i N.Veqilharxhit (1844) dhe përpjekjet e tij për një alfabet origjinal të gjuhës shqipe</p> <p>Veprat e K. Kristoforidhit dhe përpjekja e tij për afrimin e dy kryedialekteve të shqipes</p> <p>Konceptet: Ëvetar</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>Me anë formash të ndryshme të mësimdhënies nxënësit njihen e përballen me rrethanat historike të zhvillimit të gjuhës shqipe në fillimet e periudhës kombëtare.</p> <p>Nxënësit nxiten që të bëjnë dallimin e shkrimeve të N.Veqilharxhit dhe të K. Kristoforidhit nga pikëpamja e gjuhës në të cilën janë shkruar.</p> <p>Duke prezantuar tekste të shkurtra nga veprat e shkruara në fillimet e Rilindjes Kombëtare nxënësit njihen nga afër me veçoritë e gjuhës së tyre.</p> <p>Metodat:</p> <p>metoda e ndërveprimit (bashkëpunimit); metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë – me gojë e me shkrim); metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e krahasimit.</p>	<p>Nxënësi/nxënësja mund:</p> <p>1.1.1. të sqarojë rrethanat historike dhe të tregojë rëndësinë e shfaqjes së përpjekjeve të para për përpilimin e alfabetit të gjuhës shqipe dhe për mësimin e saj në shkollë;</p> <p>1.1.2. të krahasojë shkrimet e para të periudhës kombëtare dhe t’i përmendë veçoritë e tyre;</p> <p>1.1.3. të tregojë ndihmesën e K. Kristoforidhit për fillimet e zhvillimit të gjuhës letrare kombëtare shqipe.</p>
-------------	--	--	--	---

<p>1.2</p>	<p>Nxënësin/nxënësja do të jetë i/e aftë: - të tregojë veçoritë kryesore që e karakterizojnë zhvillimin të gjuhës letrare shqipe gjatë Rilindjes Kombëtare; - të tregojë çfarë e karakterizon fazën e dytë të periudhës kombëtare të zhvillimit të gjuhës letrare shqipe.</p>	<p>Zhvillimi i gjuhës shqipe gjatë Rilindjes Kombëtare</p> <p>Përpyekjet e rilindësve për të formuar një alfabet të përbashkët për gjithë shqiptarët</p> <p>Ndihmesa e kolonive shqiptare dhe qendrave të tjera për realizimin e Programit të Rilindjes kombëtare në fushë të gjuhës</p> <p>Konceptet: Alfabet i përbashkët Variant letrar</p>	<p>Veprimtaritë: Me anë formash të ndryshme të mësimdhënies nxënësit njihen e përballen me përpyekjet e rilindësve shqiptarë për krijimin e alfabetit të përbashkët dhe mbajtja e Kongresit të Alfabetit. Nxënësit nxiten të lexojnë tekste të ndryshme të rilindësve shqiptarë të shkruara në variantin e gegërishtes dhe të toskërishtes letrare për të vërejtur dallimet dhe të përbashkëtat e tyre. Duke prezantuar poezi e proza të shkurtra të shkruara për gjuhën shqipe gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare nxënësit njihen drejtpërdrejt me përcaktimet programore të tyre për zhvillimin e gjuhës letrare shqipe.</p> <p>Metodat: metoda diakronike; metoda audio-vizuale; metoda e ndërveprimit/metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë – me gojë e me shkrim); metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e krahasimit; metoda e analizës dhe sintezës.</p>	<p>Nxënësi/nxënësja mund:</p> <p>1.2.1. të tregojë e të sqarojë rrugën e zhvillimit të alfabetit të përbashkët dhe zgjidhjen e tij;</p> <p>1.2.2. të përmendë çfarë e karakterizon fazën e dytë të periudhës kombëtare të zhvillimit të gjuhës letrare shqipe;</p> <p>1.2.3. të thotë përmendësh vargje e citate për gjuhën shqipe të shkruara nga rilindësit tanë.</p>
------------	--	--	---	--

2.	Fonetikë dhe fonologji			
2.1.	<p>Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - t'i thotë përmendsh bashkëtingëlloret e gjuhës shqipe; - t'i shqiptojë e t'i shkruajë drejt bashkëtingëlloret e zëshme në trup ose në fund të fjalës, si dhe përpara një bashkëtingëlloreje tjetër të shurdhët ose para tingujve b, t, n; - të bëjë ndarjen e bashkëtingëlloreve sipas pjesëmarrjes së zërit ose të zhurmës; - t'i përdorë drejt kur shkruan e kur flet bashkëtingëlloret s, z, sh, zh dhe ç në pozicion nistor të fjalëve; - të zbatojë drejtshkrimin e ndërzanores -j- si pjesë e temës, tek emrat e gjinisë 	<p>Sistemi bashkëtingëllor i gjuhës shqipe</p> <p>Bashkëtingëlloret e zëshme b, d, dh, g, gj, v, x, xh, z dhe zh dhe përdorimi i drejtë i tyre në pozicione të ndryshme</p> <p>Bashkëtingëlloret nistore s, z, sh, zh e ç dhe drejtshkrimi i tyre</p> <p>Përdorimi i drejtë i tingujve bashkëtingëllorë j dhe h në pozicione të ndryshme</p> <p>Konceptet: Bashkëtingëllore e zëshme/e pazëshme Pozicion nistor/në trup/në fund të fjalës</p>	<p>Veprimtaritë: Për realizimin e këtyre tërësive tematike mësimdhënësi mund të organizojë ushtrime lidhur me sistemin tingullor të shqipes standarde me përqendrim te bashkëtingëlloret, duke kërkuar prej nxënësve të rikujtojnë njohuritë e mëparshme dhe të thellojnë ato me të dhëna të reja për ndarjen e bashkëtingëlloreve dhe përdorimin e tyre sipas drejtshkrimit të shqipes standarde.</p> <p>Organizohen veprimtari përgatitore konkretizuese për ilustrimin e klasifikimit të bashkëtingëlloreve sipas pjesëmarrjes së zërit dhe të zhurmës (me nëndarjet e tyre) dhe bëhen ushtrime për të vënë në pah përdorimin e drejtë të bashkëtingëlloreve në pozicione të ndryshme te fjalët.</p> <p>Me anë mjetesh të ndryshme auditive që mund të përdoren gjatë orës mësimore ilustron mënyra e drejtë e nyjetimit të tingujve përkatës bashkëtingëllorë dhe të leximit normativ e shprehës.</p> <p>Mësimdhënësi ndjek me vëmendje veprimtaritë e nxënësve dhe ndërhyr kur</p>	<p>Nxënësi/nxënësja mund:</p> <p>2.1.1. t'i thotë përmendsh bashkëtingëlloret e gjuhës shqipe;</p> <p>2.1.2. t'i shqiptojë e t'i shkruajë drejt bashkëtingëlloret e zëshme në trup ose në fund të fjalës;</p> <p>2.1.3. të bëjë ndarjen e bashkëtingëlloreve sipas pjesëmarrjes së zërit a të zhurmës;</p> <p>2.1.4. t'i përdorë drejt kur flet e kur shkruan fjalët me bashkëtingëlloret s, z, sh, zh dhe ç në fillim të fjalëve;</p> <p>2.1.5. të dallojë format e gabuara drejtshkrimore të fjalëve me bashkëtingëlloret e përmendura dhe të bëjë ndreqjen e tyre;</p>

	<p>femërore që dalin me zanore të theksuar (përveç i –së) në rasën gjinore, dhanore e rrjedhore, në njëjës të pashquar, si dhe në emërore të shquar tek emrat që dalin me temë në o të patheksuar (<i>depo, i (e) një depoje, depoja...; Kristo-Kristoja, Kajro-Kajroja...</i>); dhe 2. te disa përemra (<i>i/e tij, i tiji, të tijtë, të tijat etj.</i>);</p> <p>- ta përdorë sipas drejtshkrimit bashkëtingëlloren h në pozicione të ndryshme: a) në fillim të fjalës (<i>habit, hënë etj.</i>), b) në mes të fjalës (<i>bëhem, kthehem etj.</i>) dhe c) në fund të fjalës (<i>njoh, krah etj.</i>).</p>		<p>e sheh të udhës se ata nëpërkëmbin rregullat e drejtshkrimit e të drejtshqiptimit të gjuhës letrare shqipe. Mësimdhënësi duhet të shfrytëzojë format dhe teknikat bashkëkohore të mësimdhënies, të organizojë punën individuale, me nga dy veta dhe në gupe duke u kujdesur që nëpërmjet metodash të ndryshme ndërvepruese ta vendosë nxënësin në qendër të veprimtarive gjatë mësimdhënies, por njëkohësisht edhe t’ua mundësojë atyre të nxënë njohuritë themelore të domosdoshme.</p> <p>Metodat: metoda audio-vizuale; metoda audio-linguistike; metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë – me gojë e me shkrim); metoda e demonstrimit; metoda e krahasimit; metoda e analizës dhe sintezës; metoda e hulumtimit.</p>	<p>2.1.6. të zbatojë rregullat e drejtshkrimit lidhur me përdorimin e bashkëtingëllores j tek emrat e përemrat;</p> <p>2.1.7. t’i përdorë drejt në të folur e në të shkruar fjalët me bashkëtingëlloren h në fillim, në mes dhe në fund të fjalës.</p>
3.	Morfologji e morfosintaksë			

<p>3.1.</p>	<p>Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë: - t'i dallojë e t'i shpjegojë emrat dhe grupet leksiko-gramatikore të tyre; - ta përcaktojë emrin sipas kategorive gramatikore të tij; - t'i dijë e t'i tregojë gjedhet fjalëformuese të emrave; - të përcaktojë funksionin sintaksor të emrave në fjali dhe të japë shembuj të përdorimit të emrave me funksione të ndryshme sintaksore në fjali.</p>	<p>Pjesët e ndryshueshme të ligjëratës</p> <p>Emri</p> <p>Grupet leksiko-gramatikore të emrave</p> <p>Kategoritë gramatikore të emrit</p> <p>Formimi i emrave (nga mbiemrat, foljet, përemrat, numërorët, emrat, ndajfoljet)</p> <p>Funksionet sintaksore të emrave nëpër rasa të ndryshme</p> <p>Konceptet: Emër i përgjithshëm, i përveçëm; konkret, abstrakt; i lëndës, përmbledhës Kategoritë gramatikore: gjini, numër, rasë dhe shquarsi/ pashquarsi Emërzimi</p>	<p>Veprimtaritë: Përgatiten ushtrime për të përcaktuar grupet leksiko-gramatikore të emrave duke i pasqyruar nëpërmjet kolonash emrat e përgjithshëm e të përveçëm, emrat konkretë e abstraktë, emrat përmbledhës dhe emrat e lëndës; Bëhet përgatitja tabelare për të ilustruar kriteret e përcaktimit të kategorisë gramatikore të gjinisë e të numrit tek emrat; Me anë tekstesh të ndryshme jepen shembuj përdorimesh nëpër rasa të ndryshme të emrave për të vënë në pah funksionet e ndryshme sintaksore të rasave të emrit, por edhe të rasteve kryesore kur përdoren emrat në trajtën e shquar ose në të pashquarën; Bëhet ndërlidhja funksionale me përmbajtjet mësimore të fushës tematike Drejtshkrimi për të përsëritur përmbajtjet për shkrimin e emrave të prejardhur, të përbërë të përngjitur, a të nyjzuar, si dhe të shkrimit të tyre me shkronjën e parë të madhe a të vogël.</p> <p>Metodat: metoda e deduksionit; metoda e induksionit;</p>	<p>Nxënësi/nxënësja mund: 3.1.1. të përcaktojë se cilit grup leksiko-gramatikor i përket çdo emër; 3.1.2. të ndërtojë fjalëforma emrash me kuptime gramatikore të ndryshme duke i përdorur drejt mbaresat dhe prapashtesat përkatëse; 3.1.3. të përcaktojë kategoritë gramatikore të emrave: gjininë (sipas veçorive leksikore, morfologjike dhe sintaksore), numrin (formimin e shumësit me mjete fonetike e morfologjike, përdorimin e emrave vetëm në njëjës a vetëm në shumës si dhe dygjinishmërinë); 3.1.4. të lakojë emrin në njëjës e shumës dhe në trajtën e shquar e të pashquar dhe të identifikojë e të përcaktojë funksionin sintaksor të fjalëformës rasore përkatëse</p>
-------------	--	---	--	--

			<p>metoda e komunikimit (monolog, dialog, bisedë me gojë e me shkrim); metoda e demonstrimit; metoda e krahasimit; metoda e analizës dhe e sintezës.</p>	<p>duke dhënë shembuj për kontekste gjuhësore të ndryshme;</p> <p>3.1.5. formon emra prej emrash a prej fjalësh të tjera për shprehur nuanca të ndryshme kuptimore gjatë kuptimit;</p> <p>3.1.6. përmend shembuj të emrave të formuar sipas mënyrash të ndryshme të fjalëformimit që i përkasin leksikut që ka të bëjë me profesionin e vet të ardhshëm.</p>
3.2	<p>Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë: - të përkufizojë dhe të dallojë mbiemrat duke dhënë shembuj për ta; - të bëjë klasifikimin e mbiemrave sipas kuptimit</p>	<p>Mbiemri</p> <p>Llojet e mbiemrave sipas kuptimit leksikor</p> <p>Kategoritë gramatikore (sintaksore) të mbiemrave (gjinia, numri dhe rasa) dhe</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>Disa nga orët e parashikuara për të zhvilluar mbiemrat në fillim i kushtohen përsëritjes dhe rishikimit të njohurive paraprake lidhur me këtë lloj fjalësh emërtuese, duke rimarrë njohuritë për kuptimin dhe klasifikimin e mbiemrave si dhe për kategoritë gramatikore të tyre.</p>	<p>Nxënësi/nxënësja mund:</p> <p>3.2.1. të tregojë ç'është mbiemri dhe të dallojë llojet e mbiemrave duke dhënë shembuj për ta;</p> <p>3.2.2. i përdor drejt mbiemrat në fjali duke përcaktuar</p>

	<p>leksikor dhe sipas veçorive morfologjike të tyre;</p> <p>- t'i dallojë e t'i sqarojë kategoritë gramatikore (sintaksore) të mbiemrave dhe kategorinë e shkallës veçmas;</p> <p>- të përcaktojë mënyrën dhe mjetin gjuhësor për formimin e mbiemrave;</p> <p>- të identifikojë funksionin sintaksor të mbiemrave në fjali.</p>	<p>kategoria e shkallës (fjalëformat analitike për shkallën krahasore dhe sipërore)</p> <p>Formimi i mbiemrave (prej emrash, foljesh, numërorësh, ndajfoljesh)</p> <p>Funksionet sintaksore të mbiemrit në fjali (si përcaktor, si pjesë emërore e kallëzuesit emëror)</p> <p>Konceptet: Mbiemër: cilësues i drejtpërdrejtë dhe cilësues i ndërmjetuar; i nyjshëm, i panyjshëm Shkallët e mbiemrit: pohore, krahasore (e barazisë dhe e pabarazisë) dhe sipërore</p>	<p>Duke shfrytëzuar një material të pasur e funksional pamor e dëgjimor, kryesisht tekste, nxënësit bëjnë ushtrime me qëllim të nxitjes së ndërveprimit dinamik gjatë orës mësimore, por edhe për të mundësuar qasjen në potencialin e tyre të pranishëm dhe në aftësitë e tyre kreative. Të gjitha veprimtaritë në fillim zhvillohen në mënyrë deduktive, në mënyrë që formulimet lidhur me kuptimin e mbiemrave si grup fjalësh dhe me klasifikimin e tyre sipas kriterit semantik dhe atij morfologjik të “vërshohen” prej shembujsh të shumtë që i japin vetë nxënësit.</p> <p>Metodat: metoda e deduksionit; metoda e induksionit; metoda e ndërveprimit/metoda e komunikimit (monolog, dialog e bisedë – me gojë e me shkrim); metoda e demonstrimit; metoda e krahasimit; metoda e analizës dhe e sintezës.</p>	<p>kategoritë gramatikore të tyre dhe lidhjen me kategoritë gramatikore përkatëse të emrit që e shoqërojnë;</p> <p>3.2.3. të bëjë dallimin e mbiemrave në shkallën krahasore (të barazisë e të pabarazisë) dhe të përcaktojë nëpërmjet shembujsh shkallën pohore dhe sipërore të fjalëve mbiemra;</p> <p>3.2.4. formon mbiemra prej fjalësh të tjera dhe tregon mënyrën e fjalëformimit të tyre;</p> <p>3.2.5. tregon funksionet sintaksore që mund t'i ketë mbiemri dhe di t'i përdorë sipas drejtshkrimit të shqipes standarde mbiemrat në fjali.</p>
--	--	---	---	---

3.3	<p>Nxënësi/ nxënësja do të jetë i/e aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përcaktojë kuptimin e numërorëve dhe të dijë se çka nuk përfshihet në këtë grup fjalësh; - të dinë dallimin ndërmjet numërorëve themelorë dhe thyesave; - të njohin format për shprehjen e sasisë së përcaktuar me saktësi dhe të shprehur me përafërsi dhe t'i përdorin drejt në komunikimin me gojë e me shkrim; - t'i përcaktojnë veçoritë strukturore dhe morfologjike të numërorëve themelorë dhe atyre thyesorë. 	<p>Numërori</p> <p>Numërorët themelorë dhe numërorët thyesorë</p> <p>Përcaktimi i sasisë në mënyrë të saktë dhe të përafërt</p> <p>Veçoritë strukturore dhe morfologjike të numërorëve</p> <p>Funksionet e numërorëve në fjali</p> <p>Konceptet:</p> <p>Numëror themelor dhe thyesor</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>Veprimtaritë për shpjegimin e përmbajtjeve për numërorët fillojnë me mënyrën deduktive, ato paraqesin mundësinë e vënies në zbatim të anës gjuhësore-stilistike të përdorimit të numërorëve gjatë komunikimit me gojë e me shkrim duke i nxitur aftësitë kumtuuese të nxënësve.</p> <p>T'i kushtohet kujdes përdorimit normativ të numërorëve duke mënjanuar shkeljet gjatë fjalëformimit, drejtshkrimit dhe drejtshqiptimit me anë shembujsh për të vënë në pah shmangiet, për t'i sqaruar e për t'i përmirësuar ato.</p> <p>Metodat:</p> <p>metoda e deduksionit;</p> <p>metoda e induksionit;</p> <p>metoda e ndërveprimit/metoda e komunikimit (monolog, dialog e bisedë – me gojë e me shkrim);</p> <p>metoda e demonstrimit;</p> <p>metoda e krahasimit;</p> <p>metoda e analizës dhe e sintezës .</p>	<p>Nxënësi/nxënësja mund:</p> <p>3.3.1. t'i përcaktojë e të bëjë dallimin midis numërorëve themelorë dhe thyesave;</p> <p>3.3.2. të dallojë e të shpjegojë si formohen e si shkruhen numërorët dhe t'i shqiptojë e t'i shkruajë drejt format e fjalëve numërore për shprehjen e sasisë në mënyrë të saktë dhe të përafërt gjatë komunikimit me gojë e me shkrim;</p> <p>3.3.3. të identifikojë veçoritë morfologjike të numërorëve themelorë dhe të thyesave;</p> <p>3.3.4. të përcaktojë funksionet sintaksore të numërorëve dhe t'i përdorë në fjali pa gabim.</p>
3.4	<p>Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -të bëjë identifikimin e përemrave si një klasë fjalësh 	<p>Përemri</p> <p>Veçoritë kryesore të përemrave dhe llojet e tyre</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>Përmbajtjet mësimore për këtë kategori fjalësh mjaft komplekse kërkojnë material ilustrimi të bollshëm e</p>	<p>Nxënësi/nxënësja mund:</p> <p>3.4.1. të shpjegojë veçoritë e përemrave si një grup fjalësh treguese;</p>

	<p>më vete dhe të shpjegojë përse janë fjalë treguese;</p> <p>- të dallojë llojet e ndryshme të përemrave dhe veçoritë e tyre kuptimore e morfologjike;</p> <p>- të përcaktojë kategoritë gramatikore (gjini, vetë, numër e rasë) të formave përemërore, të vërejtë shmangiet dhe të dijë t'i përdorë si duhet kur flet e kur shkruan;</p> <p>- të tregojë funksionet e përemrave të ndryshëm në fjali dhe të ilustrojë me shembuj funksionet sintaksore të tyre.</p>	<p>Përemrat vetorë dhe fjalëformat e tyre (vetë, gjini, numër e rasë); trajtat e shkurtra dhe trajtat e bashkuara</p> <p>Veçoritë e përemrave dëftorë, pyetës, vetvetorë dhe të pacaktuar</p> <p>Kategoritë gramatikore të përemrave pronorë (pasqyrimi dhe përsëritja e tyre)</p> <p>Përdorimi dhe funksionet sintaksore të përemrave të ndryshëm</p> <p>Konceptet: Vetë, gjini, rasë, numër Trajtë e shkurtër, trajtë e bashkuar Emërzim i përemrave</p>	<p>funksional, të gërshetuar gjithmonë me punën individuale ose dyshe, sidomos te pjesa për ilustrimin e vetës e të rasës te vetorët e te pronorët.</p> <p>Zhvillimi i veprimtarive mësimore gjatë orëve për përemrat bëhet duke kombinuar vazhdimisht qasjen deduktive me atë induktive. Shumësia e formave dhe e kuptimeve gramatikore të përemrave vetvetiu shtron nevojën e zbatimit të ushtrimeve të llojllojshme, kurse përmbajtjet ilustruese duhet doemos të kenë mbështetje të pasur gjuhësore- stilistike.</p> <p>Metodat: metoda e deduksionit; metoda e induksionit; metoda e ndërveprimit/metoda e komunikimit (monolog, dialog e bisedë – me gojë e me shkrim); metoda e demonstrimit; metoda e krahasimit; metoda e analizës dhe e sintezës.</p>	<p>3.4.2. të tregojë veçoritë kuptimore dhe morfologjike të llojeve të ndryshme të përemrave;</p> <p>3.4.3. t'i identifikojë gjatë komunikimit me gojë e me shkrim fjalëformat e përemrave vetorë e pronorë, t'i vërejtë përdorimet e gabuara të tyre dhe t'i përdorë ato si duhet kur flet e kur shkruan;</p> <p>3.4.4. të shpjegojë dallimin në përdorim të formave identike të përemrave vetorë e dëftorë;</p> <p>3.4.5. t'i përmendë funksionet sintaksore të përemrave duke dhënë edhe shembuj përkatës ilustrimi për çdo funksion të tyre në fjali.</p>
--	---	---	--	---

<p>3.5</p>	<p>Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë: - të përcaktojë foljet si një klasë e veçantë fjalësh dhe t'i veçojë ato nga fjalët e tjera emërtuese;</p> <p>- të dallojë foljet me kuptim leksikor të plotë nga foljet që përdoren si mjete gramatikore (foljet ndihmëse) dhe nga foljet me kuptim leksikor të zbehur (foljet gjysmëndihmëse);</p> <p>- të bëjë dallimin midis foljeve kalimtare dhe foljeve jokalmimtare;</p> <p>- t'i përcaktojë të gjithë kategoritë gramatikore të foljeve dhe t'i tregojë veçoritë e tyre të përgjithshme;</p> <p>- të tregojë rolin e foljeve në fjali.</p>	<p>Folja</p> <p>Kuptimi emërtues i foljeve</p> <p>Foljet e mëvetësishme; foljet ndihmëse dhe foljet gjysmëndihmëse</p> <p>Foljet kalimtare dhe foljet jokalmimtare</p> <p>Kategoritë gramatikore që i ka vetëm folja (mënyrë, kohë, diatezë) dhe kategoritë e kushtëzuara të saj (veta e numri)</p> <p>Konceptet: Folje e mëvetësishme, ndihmëse, gjysmëndihmëse Folja kalimtare, jokalmimtare</p>	<p>Veprimtaritë: Duke paraqitur tekste të larmishme që lidhen drejtpërdrejt me jetën e tyre të përditshme, përkatësisht tekste që kanë të bëjnë me profesionin e tyre të ardhshëm përcaktohen dhe veçohen foljet nga fjalët e tjera dhe bëhet shpjegimi dhe përshkrimi i tyre. Me anë pyetjesh të fokusuara nxirren në pah njohuritë e tyre për foljen që i sjellin nga shkollimi fillor. Bëhen ushtrime për të ilustruar me shembuj klasifikimin e foljeve në grupe e nëngrupe dhe për të vënë në pah veçoritë e kategorive gramatikore që i kanë vetëm foljet dhe të atyre që shfaqen edhe te klasat e tjera të fjalëve.</p> <p>Metodat: metoda e deduksionit; metoda e induksionit; metoda e ndërveprimit/metoda e komunikimit (monolog, dialog e bisedë – me gojë e me shkrim); metoda e demonstrimit; metoda e krahasimit; metoda e analizës dhe e sintezës.</p>	<p>Nxënësi/nxënësja mund:</p> <p>3.5.1. të thotë ç'është folja dhe ta dallojë nga fjalët e tjera;</p> <p>3.5.2. të tregojë e të përdorë foljet me kuptim leksikor të plotë, foljet ndihmëse dhe foljet gjysmëndihmëse;</p> <p>3.5.3. të identifikojë foljet kalimtare dhe jokalmimtare në fjali;</p> <p>3.5.4. t'i përdorë drejt të gjitha llojet e foljeve në situata ligjërimore të ndryshme dhe t'i zbatojë ashtu si duhet kategoritë e foljeve në tekst;</p> <p>3.5.5. të përshkruajë e të dallojë grupet e foljeve, të formulojë drejt shembujt duke përdorur në mënyrë adekuate kategoritë gramatikore të foljeve në pajtim me grupin përkatës të foljeve.</p>
------------	--	--	--	---

4.	Sintaksë			
4.1	<p>Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përcaktojë fjalinë e paplotë dhe veçoritë kryesore të saj; - të tregojë ndarjen dhe të sqarojë veçoritë e llojeve të fjalisë së paplotë. 	<p>Sintaksa e fjalisë</p> <p>Fjalja e paplotë</p> <p>Kuptimi dhe llojet e fjalive të paplota</p> <p>Fjalitë e paplota (kontekstuale, situatave, eliptike)</p> <p>Konceptet:</p> <p>Fjalitë e paplota Fjalitë kontekstuale Fjalitë eliptike</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>Për përgatitjen e veprimtarive për këtë pjesë shfrytëzohen tekste të afërta për nxënësit e që lidhen me komunikimin e tyre të përditshëm. Nëpërmjet pyetjesh të fokusuara bëhet ndërlidhja me njohuritë e mëparshme lidhur me fjalinë dhe veçoritë e saj.</p> <p>Me anë të shembujve ilustrues në kuadër të veprimtarisë përgatitore u shpjegohen nxënësve veçoritë kryesore të fjalisë së paplotë.</p> <p>Bëhen veprimtari konkretizimi me shembuj të shumtë në mënyrë që nxënësit nëpërmjet punës individuale, në grupe dhe punës nga dy veta të kuptojnë dhe të dallojnë fjalitë e paplota kontekstuale, situatave dhe eliptike.</p> <p>Nëpërmjet një tablele të përgatitur me tri kolona me shembuj ilustrimi të konkretizohet ndarja e fjalive të paplota.</p> <p>Metodat:</p> <p>monolog-dialog; metoda e demonstrimit/metoda e ilustrimit; metoda e analizës dhe sintezës.</p>	<p>Nxënësi/nxënësja mund:</p> <p>4.1.1. të tregojë kuptimin dhe veçoritë kryesore të fjalisë së paplotë;</p> <p>4.1.2. të identifikojë llojet e ndryshme të fjalive të paplota dhe tregojë veçoritë e tyre.</p>

4.2	<p>Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përcaktojë fjalinë e pagjymtyrëzueshme dhe veçoritë kryesore të saj; - të tregojë ndarjen dhe të sqarojë veçoritë e llojeve të fjalisë së pagjymtyrëzueshme. 	<p>Kuptimi dhe llojet e fjalive të pagjymtyrëzueshme</p> <p>Fjalitë e pagjymtyrëzueshme (të pohimit, të mohimit, pyetëse, nxitëse)</p> <p>Konceptet:</p> <p>Fjalitë e pagjymtyrëzueshme Pohore Mohore Pyetëse Nxitëse</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>Për përgatitjen e veprimtarive për këtë pjesë shfrytëzohen tekste të afërta për nxënësit e që lidhen me komunikimin e tyre të përditshëm. Nëpërmjet pyetjesh të fokusuara bëhet ndërlidhja me njohuritë e mëparshme lidhur me fjalinë dhe veçoritë e saj.</p> <p>Me anë të shembujve ilustrues në kuadër të veprimtarisë përgatitore u shpjegohen nxënësve veçoritë kryesore të fjalisë së paplotë.</p> <p>Bëhen veprimtari konkretizimi me shembuj të shumtë në mënyrë që nxënësit nëpërmjet punës individuale, në grupe dhe punës nga dy veta të kuptojnë dhe të dallojnë fjalitë e paplota kontekstuale, situatave dhe eliptike.</p> <p>Nëpërmjet një tablele të përgatitur me tri kolona me shembuj ilustrimi të konkretizohet ndarja e fjalive të paplota.</p> <p>Metodat:</p> <p>monolog-dialog; metoda e demonstrimit/metoda e ilustrimit; metoda e analizës dhe sintezës.</p>	<p>Nxënësi/nxënësja mund:</p> <p>4.2.1. të tregojë kuptimin dhe veçoritë kryesore të fjalisë së paplotë;</p> <p>4.2.2. të identifikojë llojet e ndryshme të fjalive të paplota dhe tregojë veçoritë e tyre</p>
-----	--	--	--	---

4.3	<p>Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përcaktojë fjalinë e thjeshtë me dy gjymtyrë kryesore dhe lidhjen e kallëzuesisë; - të identifikojë kryefjalën dhe të tregojë me se shprehet ajo; - të përcaktojë kallëzuesin, të tregojë tipat e kallëzuesit dhe shprehjen e tyre; - të tregojë përshtatjen e kryefjalës me kallëzuesin. 	<p>Fjalja e thjeshtë me dy gjymtyrë kryesore</p> <p>Kryefjala</p> <p>Kallëzuesi</p> <p>Konceptet: Kallëzuesi Kryegjymtyrë Kallëzues foljor, emëror Kallëzues me pjesë të pandryshueshme të ligjëratës</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>Gjatë realizimit të veprimtarive për këtë pjesë të programit përdoren tekste që kanë të bëjnë me preokupimet dhe përditshmërinë e nxënësve. Nëpërmjet pyetjesh me synim të caktuar përsëriten njohuritë e mëparshme lidhur me fjalinë dhe gjymtyrët e saj përbërëse. Organizohen ushtrime për të vënë në dukje gjymtyrët kryesore të fjalisë së thjeshtë dhe përshtatjen e kryefjalës me kallëzuesin. Bëhet paraqitja skematike e strukturës së fjalisë së thjeshtë dykryegjymtyrëshe (të pazgjeruar e të zgjeruar). Me anë shembujsh të larmishëm sqarohet lidhja kallëzuesore (kallëzuesia) dhe shpjegohet shprehja e kryefjalës. Gjithashtu jepen shpjegime edhe për kallëzuesin, për tri llojet e tij dhe mjetet e shprehjes.</p> <p>Metodat: monolog-dialog; metoda e demonstrimit/metoda e ilustrimit; metoda e analizës dhe sintezës.</p>	<p>Nxënësi /nxënësja mund:</p> <p>4.3.1. të tregojë veçoritë kryesore të fjalisë së thjeshtë me dy gjymtyrë kryesore dhe lidhjen e kallëzuesisë;</p> <p>4.3.2. të identifikojë kryefjalën dhe të përmendë mjetet për shprehjen e saj;</p> <p>4.3.3. të dallojë kallëzuesin si bërthamë organizuese e fjalisë dhe të tregojë llojet e kallëzuesve e shprehjen e tyre;</p> <p>4.3.4. të japë shpjegime lidhur me përshtatjen e gjymtyrëve kryesore mes vete dhe t'i përdorë si duhet kur ndërton fjali.</p>
-----	---	---	--	--

4.4	<p>Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përcaktojë gjymtyrët e dyta të fjalisë dhe të tregojë kategoritë kryesore të tyre; - të identifikojë kundrinorin, të tregojë llojin dhe shprehjen e tij. 	<p>Gjymtyrët e dyta të fjalisë</p> <p>Veçoritë dhe kategoritë kryesore të gjymtyrëve të dyta të fjalisë</p> <p>Kundrinori dhe llojet e tij</p> <p>Konceptet: Gjymtyrët e dyta të fjalisë Kundrinori i drejtë Kundrinori i zhdrejtë</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>Veprimtaritë për këtë pjesë përgatiten duke shfrytëzuar tekste të afërta për nxënësit e që lidhen me komunikimin e tyre të përditshëm. Nëpërmjet pyetjesh të ndryshme bëhet ndërlidhja me njohuritë e mëparshme lidhur me fjalinë dykryegjymtyrëshe dhe veçoritë e saj. Bëhet paraqitja skematike e strukturës së fjalisë së thjeshtë dykryegjymtyrëshe të zgjeruar duke dhënë shpjegime për gjymtyrët e dyta, rolin dhe shprehjen e tyre në fjali.</p> <p>Bëhen veprimtari konkretizimi me shembuj të shumtë në mënyrë që nxënësit nëpërmjet punës individuale, në grupe dhe punës nga dy veta të kuptojnë e të dallojnë kundrinorin në fjali, të përcaktojnë llojin e tij dhe të tregojnë me se shprehet ai.</p> <p>Metodat: monolog-dialog; metoda e demonstrimit/metoda e ilustrimit; metoda e analizës dhe sintezës.</p>	<p>Nxënësi/nxënësja mund:</p> <p>4.4.1: të dallojë e të shpjegojë rolin e gjymtyrëve të dyta në fjali;</p> <p>4.4.2: të identifikojë kategorinë e gjymtyrës së dytë;</p> <p>4.4.3: të dallojë kundrinorin nga gjymtyrët e tjera të dyta dhe të tregojë me se shprehet ai në fjali;</p> <p>4.4.4: të dallojë kundrinorin e drejtë nga kundrinori i zhdrejtë, si dhe llojet e kundrinorit të zhdrejtë.</p>
5.	Drejtshkrim			
	Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:	Shenjat e pikësimit . ?!„“	Veprimtaritë:	Nxënësi/nxënësja mund:

5.1.	<p>-t'i përdor drejt shenjat e pikësimit;</p> <p>-vëren dhe ndreq gabimet që lidhen me përdorimin e shenjave të pikësimit.</p>	<p>Konceptet: Pikë Pikëpyetje Pikëçuditje Thonjëza</p>	<p>Prezantohen disa rregulla për përdorimin e shenjave të pikësimit sipas Drejtshkrimit të gjuhës letrare shqipe. Bëhet paraqitja e shembujve të përgatitur për të ilustruar e për të sqaruar përdorimin e drejtë të shenjave të pikësimit. Merren shembuj nga tekstet që u përkasin stileve funksionale të ndryshme.</p> <p>Bëhen ushtrime në mënyrë që nxënësit vetë të bëjnë ndreqjen e gabimeve gjatë përdorimit të shenjave të pikësimit. Përdoret edhe forma e diktimit për të parë shkallën e zotërimit të rregullave për përdorimin si duhet të shenjave të pikësimit.</p> <p>Metodat: metoda e monologut/dialogut; metoda e punës me tekst; metoda e demonstrimit.</p>	<p>5.1.1. të shpjegojë funksionin dhe rëndësinë e shenjave të pikësimit;</p> <p>5.1.2. të bëjë dallimin midis shenjave të pikësimit dhe shenjave të drejtshkrimit ;</p> <p>5.1.3. t'i përdorë drejt shenjat e pikësimit.</p>
6.	Komunikimi praktik profesional			
6.1	<p>Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë: - të bëjë CV e biografi dhe të bëjë dallimin midis këtyre dy formave;</p>	<p>CV / biografi Raport Ofertë</p>	<p>Veprimtaritë : Secili nxënës të përpilojë nga një tekst sipas rregullave të përcaktuara për formën dhe përmbajtjen e teksteve. Nxënësit i shkruajnë tekstet sipas</p>	<p>Nxënësi/nxënësja mund: 6.1.1. të përcaktojë rregullat për përpilimin e teksteve praktike-profesionale;</p>

	<p>-t'i dallojë format e teksteve praktike-profesionale dhe t'u përmbahet rregullave për t'i shkruar tekstet e tilla.</p>		<p>instruksioneve të mësimdhënësit dhe kontrollimi i tyre bëhet me anë të njoftimit prapaveprues. Nxënësit nxiten të gjejnë përmbajtje dhe formagjuhësore komunikimi në saje të të cilëve do të pasurojnë terminologjinë e vet profesionale për ta përdorur kur të shkruajnë tekste praktike-profesionale.</p> <p>Metodat: metoda e monologut-dialogut; metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst.</p>	<p>6.1.2. të bëjë paraqitjen e rregullave të komunikimit praktik-profesional; 6.1.3. të përpilojë tekste praktike-profesionale; 6.1.4. t'i zbatojë rregullat e drejtshkrimit gjatë shkrimit të teksteve.</p>
--	---	--	--	--

Njësia modulare: LETËRSI				
Nr. rend	Rezultatet nga të nxënit	Përmbajtjet dhe konceptet	Veprimtaritë dhe metodat	Kriteret për vlerësim
1.	Romantizmi evropian			
1.1.	<p>Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -të identifikojë kohën dhe rrethanat, në të cilat u paraqit romantizmin si drejtim letrar, shkollë letrare ose formacion stilistikor; -të dallojë romantizmin si metodë letrare dhe si drejtim letrar; -të dallojë fazat e zhvillimit të romantizmit evropian dhe përfaqësuesit kryesor; -të dallojë karakteristikat e romantizmit, duke i krahasuar me ato të dejttimeve letrare që i paraprijnë; 	<p>Romantizmi në letërsinë evropiane, fazat e zhvillimit të tij dhe përfaqësuesit kryesorë</p> <p>Konceptet: Romantizmi si drejtim letrar, shkollë letrare apo formacion stilistikor; Romantizmi si metodë letrare, karakteristikat e romantizmit.</p>	<p>Veprimtaritë: Duke bërë bisede mbi kohën dhe rrethanat historike, mbi pararomantizmin, që ishte i mbështetur në humanizmin iliminist, shpjegohet koha dhe rrethanat që mundësuan lindjen e romantizmit si drejtim letrar. Për t`i orientuar nxënësit, jepet shpjegimi se romantizmi si metodë letrare, ka karakter ahistorik, për dallim nga romantizmi si shkollë letrare që ka karakter historik dhe që ju kundërvihet rregullave të klasicizmit, gjegjesisht rrethanave të kohës apo shoqërisë feudale, aristokracisë dhe klerikalizmit dhe vendos parime të reja, të cilat do t`i përgjigjen shoqërisë së re. Nxiten nxënësit, në formë të përsëritjes, të përkujtohen në karakteristikat e klasicizmit dhe duke folur për një karakteristikë të caktuar të tij, p.sh. raportit ndaj realitetit, objektivës dhe arsyes, të cilën e rekomandonin klasicistët, romantikët kujdes të posaçëm ju kushtonin ndjenjave, gjegjesisht subjektivës (kështu, në</p>	<p>Nxënësi/nxënësja mund:</p> <ul style="list-style-type: none"> 1.1.1. të identifikojë kohën dhe rrethanat e dominimit të romantizmit si drejtim letrar; 1.1.2. të bëjë dallim mes romantizmit si metodë letrare dhe si drejtim letrar; 1.1.3. t`i memorojë karakteristikat kryesore të romantizmit evropian; 1.1.4. t`i dallojë dhe t`i emërtojë fazat e zhvillimit të romantizmit evropian.

	<p>-të identifikojë gjinitë letrare më të zhvilluara në letërsinë e romantizmit;</p> <p>-të dallojë specificitetet e romantizmit francez e me pastaj edhe atij gjerman, anglez, amerikan dhe rus.</p>		<p>formë të krahasimit shpjegohen edhe karakteristikat tjera).</p> <p>Romantikët i përkrahën pa rezerve kërkesat e Revolucionit borgjez - Liri, barazi, vëllazëri.</p> <p>Duke u ndalë në emrat e përfaqësuesve me të njohur të romantizmit evropian, shpjegohen fazat e zhvillimit të romantizmit dhe karakteristikat e secilës fazë.</p> <p>Duke përmendur reprezentë të caktuar të letërsisë gjermane, franceze, angleze, amerikane e ruse, mundohemi të shpjegojmë se, sikurse gjithë drejtimet tjera letrare, ashtu edhe romantizmi, në mjedise të caktuara, karakterizohet me specificitete të veta.</p> <p>Jepen shpjegime rreth gjinive dhe llojeve letrare më të zhvilluara në letërsinë e romantizmit evropian.</p> <p>Metodat: metoda e krahasimit; metoda e ndërveprimit /metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë); metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit.</p>	
1.2.	<p>Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë: -të dallojë veçoritë kryesore të veprës së Bajronit;</p>	<p>Xhorxh Gordon Bajron - jeta dhe vepra</p>	<p>Veprimtaritë: Duke përsëritur karakteristikat e romantizmit anglez dhe përfaqësuesit më të njohur të tij,</p>	<p>Nxënës/nxënësja mund: 1.2.1. të identifikojë veprën e Bajronit;</p>

	<p>-të shpjegojë jetën dhe rrethanat jetësore të Bajronit;</p> <p>-t`i numërojë fazat e krijimtarisë letrare të Bajronit dhe veprat kryesore të secilës fazë;</p> <p>-të dallojë risitë që solli arti i Bajroni, nëpërmjet të analizës bërë romanit të tij <i>"Udhëtimet e Çajlld Haroldit"</i>;</p> <p>-të identifikojë elementin tipik romantik te Bajroni.</p>	<p>Konceptet:</p> <p>Risitë që solli arti i Bajronit, personazhi tipik romantik në veprat e Bajronit</p> <p>Individualisti që revoltohet e që mbushet plot vrer nga padrejtësitë</p>	<p>ndalemi në informacionet kryesore mbi jetën dhe veprën e Bajronit.</p> <p>Pyeten nxënësit se cilat vepra të Bajronit i kanë të njohura dhe çfarë risish sjell arti i tij. Në formë të bashkëbisedimit, gjegjësisht pyetjeve dhe përgjigjeve, jepen të dhëna për fazat e krijimtarisë letrare të Bajronit dhe për veprat më të njohura të secilës fazë.</p> <p>Lexohet fragmenti i dhënë në libër (nga poema <i>"Udhëtimet e Çajlld Haroldit"</i>) dhe pyeten nxënësit se kush e ka lexuar veprën dhe sa janë në gjendje ta analizojnë.</p> <p>Bashkë me nxënësit bëhet analiza e poemës dhe analiza e personazhit kryesor.</p> <p>Duke analizuar personazhin kryesor të veprës dhe jetën e Bajronit, mundohemi të gjejmë lidhjen e ngushtë mes tyre.</p> <p>Metodat:</p> <p>metoda e ndërveprimit /metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë);</p> <p>metoda e demonstrimit;</p> <p>metoda e punës me tekst;</p> <p>metoda e ilustrimit.</p>	<p>1.2.2. të dallojë veçoritë e artit të Bajronit;</p> <p>1.2.3. ta analizojë poemën <i>"Udhëtimet e Çajlld Haroldit"</i>;</p> <p>1.2.4. ta analizojë Haroldin si personazh;</p> <p>1.2.5. ta përcaktojë vendin e Bajronit në letërsinë botërore.</p>
--	---	---	---	---

<p>1.3.</p>	<p>Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë: - të identifikojë veçoritë e artit të Pushkinit;</p> <p>-të njohë rrethanat jetësore të Pushkinit;</p> <p>-të kuptojë rëndësinë e romanit të Pushkinit;</p> <p>-nëpërmjet të subjektit të romanit <i>“Eugjen Onjegini”</i>, të identifikojë elementet romantike të veprës së Pushkinit;</p> <p>-të shpjegojë ngjarjet kryesore që trajtohen në roman;</p> <p>-të analizojë personazhet kryesore të dy veprave të Pushkinit;</p> <p>-të dallojë veçoritë kryesore të artit të Pushkinit;</p>	<p>A.S. Pushkin - jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet:</p> <p>Romantizmi rus</p> <p>Çrrënjësja e feudalizmit dhe bujkërobërisë</p> <p>Ndërtimi i personazheve, shumësia e personazheve në romanin <i>“Eugjen Onjegini”</i>.</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>Në formë të përsëritjes, nxiten nxënësit të shprehen në lidhje me karakteristikat dhe veçantitë e romantizmit rus dhe përfaqësuesit kryesor të tij.</p> <p>Ndalemi në jetën dhe veprën e Pushkinit, duke dhënë informacion edhe për epokën, në të cilën jetoi dhe veproi.</p> <p>Nxiten nxënësit të shprehen në lidhje me veprat e Pushkinit për të cilat kanë dëgjuar, i kanë lexuar ose i kanë parë si realizime filmike.</p> <p>Në formë të bashkëbisedimit, analizohet vepra <i>“Eugjen Onjegini”</i> dhe jepen gjykime për temën dhe idenë e veprës</p> <p>-në formë të bashkëbisedimit, nxiten nxënësit të shprehin mendimet e tyre për personazhet kryesore të romanit, Onjeginin, Tatanjanën dhe Lenskin;</p> <p>-pasi të analizohet vepra dhe të lexohet e komentohet fragmenti i dhënë në libër, kërkohet nga nxënësit që të prononcohen në lidhje me personazhet kryesore të romanit dhe vlerën e romanit;</p> <p>-nxiten nxënësit që të japin gjykime në lidhje me vendin që zë Pushkini në letërsinë botërore.</p> <p>Metodat:</p> <p>metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë); metoda e demonstrimit;</p>	<p>Nxënësi mund:</p> <p>1.3.1. ta kuptojë rolin dhe vendin që zë Pushkinit në letërsinë botërore;</p> <p>1.3.2. të identifikojë stilin e veprave të Pushkinit;</p> <p>1.3.3. të analizojë romanin e Pushkinit dhe të kuptojë jetën ruse në fillim të shekullit XIX;</p> <p>1.3.4. t`i analizojë personazhet kryesore të romanit <i>“Eugjen Onjegini”</i>;</p> <p>1.3.5. të japë gjykime rreth personazheve kryesore të romanit të Pushkinit, duke analizuar letrën e Tatjanës drejtuar Onjeginin.</p>
-------------	--	---	--	--

	<p>- të identifikojë elementet erotike, patriotiko-shoqëror dhe peizazhiste në poezitë e Pushkinit.</p>		<p>metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit; metoda e krahasimit.</p>	
--	---	--	---	--

2.	Letërsia e rilindjes kombëtare			
2.1	<p>Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:</p> <p>-të dallojë nocionin Rilindja Kombëtare (që ka karakter historik) nga letërsia e romantizmit shqiptar, që është nocion më i ri dhe në përjasje me konceptet teotike-letrare moderne;</p> <p>-të dallojë veprat e Rilindjes Kombëtare prej veprave të romantizmit;</p> <p>-ta kuptojë rolin që luan historia në letërsinë e kësaj periudhe;</p> <p>-të numërojë dhe emërtojë përfaqësuesit kryesorë të Rilindjes Kombëtare: Jeronim de Radën, Anton Santorin, Pashko Vasën, Naim Frashërin, etj.</p>	<p>Letërsia e Rilindjes Kombëtare</p> <p>Konceptet: Ngritja e ndërgjegjes kombëtare, gjuhësore, arsimore, kulturore, historike</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>Jepen shpjegime për nocionin Rilindje Kombëtare dhe për ndikimin e Perandorisë Osmane në zhvillimin e saj, lëkundjen e themeleve të Perandorisë me formimin e dy pashallëqeve të mëdha, atij të Bushatasve të Shkodrës dhe pashallëkut të Ali Pashë Tepelenës.</p> <p>Pyeten nxënësit a kanë lexuar veprat e ndonjë përfaqësuesi të madh të Rilindjes Kombëtare dhe a janë në gjendje të kuptojnë rrethanat e zhvillimit të Rilindjes.</p> <p>Jepet shpjegimi se krijuesit e kësaj periudhe ishin ideologë të lëvizjes kombëtare.</p> <p>Veprat që rradhiteshin para Lidhjes së Prizrenit (si <i>Letërqarkorja</i> dhe <i>Permbledhje këngësh popullore dhe rapsodish shqiptare</i>), gjatë Lidhjes së Prizrenit (<i>Bleta shqiptare, E vërteta për Shqipërinë dhe shqiptarët</i>) dhe pas Lidhjes së Prizrenit (<i>Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do bëhet</i>).</p> <p>Metodat: metoda e komunikimit (monolog, dialog); metoda e demonstrimit;</p>	<p>Nxënësi/nxënësja mund:</p> <p>2.1.1. të bëjë dallim mes nocionit Rilindje dhe romantizëm;</p> <p>2.1.2. të identifikojë ideologjitë kombëtare të Rilindjes;</p> <p>2.1.3. të kuptojë lidhjet historike dhe artistike;</p> <p>2.1.4. t'i emërtojë përfaqësuesit kryesor të Rilindjes Kombëtare dhe kryeveprat e tyre.</p>

			metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit; metoda e krahasimit.	
2.2	<p>Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të identifikojë kohën dhe rrethanat, në të cilat u paraqit romantizmi shqiptar si drejtim letrar, shkollë letrare ose formacion stilistikor; -të dallojë romantizmin si metodë letrare dhe si drejtim letrar; -të dallojë etapat e zhvillimit të romantizmit shqiptar dhe përfaqësuesit kryesorë; -të dallojë karakteristikat e romantizmit, duke i krahasuar me Rilindjen Kombëtare; -të identifikojë gjinitë letrare më të zhvilluara në letërsinë e romantizmit; 	<p>Romantizmi në letërsinë shqiptare</p> <p>Konceptet: Romantizmi si drejtim letrar, shkollë letrare apo formacion stilistikor; Romantizmi si metodë letrare, karakteristikat e romantizmit</p>	<p>Veprimtaritë: Duke bërë bisedë mbi kohën dhe rrethanat historike të pararomantizmit, që ishte i mbështetur në Rilindjen Kombëtare, shpjegohet koha dhe rrethanat që mundësuan lindjen e romantizmit si drejtim letrar. Për t`i orientuar nxënësit, jepet shpjegimi se romantizmi shqiptar si drejtim letrar, fillon gati në të njëjtën kohë me romantizmin botëror, por vazhdon më gjatë deri në fund të shekullit XIX. Romantizmi shqiptar ka karakter të ngjajshëm me atë botëror, por ka edhe specificitetet e veta që lidhen me kontekstin dhe rrethanat nëpër të cilat kalonin shqiptarët. Nxiten nxënësit, në formë të përsëritjes, të përkujtohen në karakteristikat e romantizmit evropian dhe të krahasohet me ato të romantizmit shqiptar. Ashtu si romantikët evropian edhe romantikët shqiptarë i kanë kushtuar kujdes krijimtarisë popullore, nga e cila trashëguan si formë të ligjeratës poetike- poezinë lirike. Duke u ndalë në emrat e përfaqësuesve më të njohur të romantizmit shqiptarë, shpjegohen</p>	<p>Nxënësi/nxënësja mund:</p> <p>2.2.1. të identifikojë kohën dhe rrethanat e dominimit të romantizmit si drejtim letrar;</p> <p>2.2.2. të bëjë dallim mes romantizmit si metodë letrare dhe si drejtim letrar;</p> <p>2.2.3. t`i memorojë karakteristikat kryesore të romantizmit shqiptar;</p> <p>2.2.4. t`i dallojë dhe t`i emërtojë etapat e zhvillimit të romantizmit shqiptar.</p>

	-të dallojë specificitetet e romantizmit shqiptar.		etapat e zhvillimit të romantizmit dhe karakteristikat e secilës etapë. Metodat: metoda e komunikimit (monolog, dialog dhe bisedë); metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit; metoda e krahasimit.	
2.3	<p>Nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë: -ta kuptojë rolin që luan vepra e De Radës në letërsinë shqiptare;</p> <p>-të identifikojë figurën poliendrike, të poetit, folkloristit, publicistit, filologut, estetit, mësuesit - Jeronim de Rada;</p> <p>-të identifikojë elementet popullore në veprën e De Radës;</p> <p>-të njoh rrethanat, në të cilat u krijua vepra e De Radës;</p>	<p>Jeronim de Rada - jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet: Gjuha poetike, dramaturgjike, shkencore Atdhetarizmi Gazeta Metrika</p>	<p>Veprimtaritë: Jepen informacione për jetën dhe veprën e Jeronim de Radës, duke u ndalë në veprimtarinë e tij. Nxiten nxënësit që t'i shprehin mendimet e tyre rreth asaj se sa i kanë kuptuar dhe sa ju kanë pëlqyer poemat <i>"Këngët e Milosaos"</i> dhe <i>"Këngët e Serafina Topisë"</i>. Nxënësit ndahen në grupe dhe secilit grup i jepet për detyrë ta analizojë një poemë dhe kërkohet që çdo grup, nëpërmjet të një përfaqësuesi të zgjedhur, të bëjë analizë. Pasi çdo grup bën analizën e poemës së dhënë, hapet diskutim dhe nxiten nxënësit të mendojnë dhe të shprehin në lidhje me raportin e poemave me letërsinë popullore. Bashkë me nxënësit lexohet dhe analizohet fragmenti nga libri.</p>	<p>Nxënësi/nxënësja mund:</p> <p>2.3.1. të dallojë veçoritë e artit të De Radës;</p> <p>2.3.2. ta kuptojë rolin që luan vepra e De Radës, e cila karakterizohet me një raport të ngushtë me krijimtarinë gojore;</p> <p>2.3.3. ta analizojë rolin e historisë në veprën e De Radës dhe ta deshifrojë simbolikën e saj.</p>

	-të analizojë <i>“Këngët e Milosaos”</i> dhe <i>“Këngët e Serafina Topisë”</i> .		Nxënësve ju jepet si detyrë shtëpie që, sipas dëshirës, të analizojnë një personazh nga poemat e analizuara. Punimet më të mira lexohen dhe komentohen në klasë. Metodat: metoda e komunikimit; metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit; metoda e krahasimit.	
2.4	Nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë: -ta kuptojë rolin që luan vepra e Gavril Darës në letërsinë shqiptare; -të identifikojë figurën e shkrimtarit të shquar arbëresh; -të identifikojë elementet popullore në veprën e Gavril Darës;	Gavril Dara i Ri - jeta dhe vepra Konceptet: Gjuha arbëreshe poetike, shkencore Metrika Atdhetarizmi	Veprimtaritë: Jepen informacione për jetën dhe veprën e Gavril Darës, duke u ndalë në veprimtarinë e tij. Në formë të përsëritjes diskutohet rreth jetës së arbëreshëve, menyrës së ruajtjes së traditës, zakoneve dhe letërsisë gojore. Analizohen idetë revolucionare të Darës. Lexohet dhe komentohet fragmenti i poemës nga libri duke u përqëndruar në analizën e personazheve, konkretisht, në personazhin e Balës, që simbolizon vetë poetin.	Nxënësi/nxënësja mund: 2.4.1. të dallojë veçoritë e artit të Gavril Darës; 2.4.2. ta kuptojë rolin që luan vepra e Darës, e cila karakterizohet me një lidhje të ngushtë me krijimtarinë gojore; 2.4.3. ta analizojë paraqitjen historike në veprën e Darës dhe ta deshifrojë simbolikën e saj.

	<p>-të njoh rrethanat, në të cilat u krijua vepra e Gavril Darës, trashëgimia familjare , nga gjyshi dhe babai;</p> <p>-të analizojë poemën “<i>Kënka e sprasme e Balës</i>”.</p>			
2.5	<p>Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:</p> <p>-ta përshkruajë rrugën jetësore të Zef Serembes dhe kontributin e tij në letërsinë shqiptare;</p> <p>-të memorojë poezitë e Serembes dhe të numërojë preokupimet tematike të poezisë lirike të Serembes;</p> <p>-t’i dallojë vlerat letrare dhe tematikën e poezive të Serembes;</p> <p>-të përcaktojë vendin që zë Zef Serembe në letërsinë shqipe, në përgjithësi.</p>	<p>Zef Serembe– jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet: Lirika Poezitë italiane dhe këngët origjinale të përkthyer Lirika patriotike dhe e dashurisë.</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>Jepen informacione për rrugën jetësore të Serembes dhe poezitë e tij kryesore. Pyeten nxënësit se cilat janë veprat më të njohura lirike të Serembes. Me ndihmën e nxënësve, analizohet “<i>Rrotullupë</i>”, “<i>Për lirinë e Venetisë</i>”, “<i>Kënka e mallit të parë</i>”, “<i>Fytyra e saj</i>”, “<i>Më të bukurës në Strigar</i>”.</p> <p>Pasi lexohen poezitë e Serembes, diskutohet rreth raportit të poezive me letërsinë gojore. Diskutohet rreth preokupimeve tematike të lirikës patriotike të Serembes. Jepen informacione për dashurinë e Zefit dhe inspirimin që ai mori nga kjo dashuri. Në formë të rezimesë, kërkohet nga nxënësit që t’i shprehin mendimet e tyre rreth vendit të Serembes në jetën shoqërore, kulturore dhe letrare të kësaj periudhe.</p> <p>Metodat: metoda e komunikimit;</p>	<p>Nxënësi /nxënësja mund:</p> <p>2.5.1. ta përcaktojë vendin e Serembes në letërsinë tonë kombëtare;</p> <p>2.5.2. t’i numërojë poezitë më të njohura të Zef Serembes;</p> <p>2.5.3. ta analizojë poezitë e Serembes.</p>

			metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit; metoda e krahasimit.	
2.6	<p>Nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë:</p> <p>-të kuptojë vendin që zë Anton Santori në letërsinë shqipe;</p> <p>-të fitojë njohuri mbi jetën dhe veprën e Anton Santorit;</p> <p>-nëpërmjet të dramës të Santorit, të njihet me rrugën zhvillimore të llojit të dramatikës në letërsinë shqipe gjatë Rilindjes Kombëtare;</p> <p>-të identifikojë preokupimet tematike të veprave të Anton Santorit;</p> <p>-ta shpegojë dhe analizojë dramën "Emira";</p> <p>-t'i numërojë dhe emërtojë veprat tjera të botuara dhe</p>	<p>Anton Santori - jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet: Gjinitë letrare Llojet letrare Preokupimet tematike Personazhet Dramat Veprat fetare dhe jashtëfetare Poezitë satike-humoristike Novelat Romanet</p>	<p>Veprimtaritë: Jepen informacione të përgjithshme për jetën dhe veprën e Anton Santorit. Shpjegohet kontributi i Santorit në romantizmin arbëresh si dramaturgu i parë. Lexohet fragmenti i dhënë nga drama "Emira" dhe nxiten nxënësit që të mendojnë rreth temës së dramës. Jepen shpjegime shtesë mbi këtë dramë dhe kërkohet nga nxënësit që të analizojnë personazhet e dramës: Emira, Miriani, Kallonjери, Kalina. Jepen informacione për temat e novelave dhe romaneve të Anton Santorit. Nxiten nxënësit të shprehin mendimet e tyre mbi Santorin si dramaturg dhe vendit që zë ai në letërsinë shqipe.</p> <p>Metodat: metoda e komunikimit; metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst.</p>	<p>Nxënësi /nxënësja mund:</p> <p>2.6.1. të fitojë pasqyrë të përgjithshme mbi vendin e Anton Santorit në letërsinë shqipe;</p> <p>2.6.2. të përmend novelat, romanet, dramat, melodramat të mbetura në dorëshkrim;</p> <p>2.6.3. t'i numërojë preokupimet tematike të veprave të Santorit;</p> <p>2.6.4. të analizojë dramën "Emira";</p> <p>2.6.5. të analizojë personazhet kryesore të kësaj drame;</p> <p>2.6.6. të dallojë komponentën e rëndësishme të strukturës kompozicionale të dramës,</p>

	<p>ato të mbetura në dorëshkrim të Anton Santorit;</p> <p>-t`i përmend preokupimet tematike të veprave të Santorit.</p>			<p>dashurinë mes Emirës dhe Mirianit.</p>
2.7	<p>Nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë:</p> <p>-t`i identifikojë rrethanat, në të cilat u paraqit dhe u krijua figura markante atdhetare e Rilindjes Kombëtare, Naim Frashëri;</p> <p>-të njohë jetën dhe veprën e N. Frashërit;</p> <p>-të numërojë kontributin e Naimit në më shumë sfera të dijes, si në: diplomaci, gjuhësi, veprimtari përkthyes, dhe letërsi;</p> <p>-të memorojë llojet e lirikës dhe epikës që lëvroi Naimi;</p>	<p>Naim Frasheri- jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet: Gjuhësia Diplomacia Lirika Epika në gjuhën shqipe Gjuhët orientale dhe gjuha greke "Bilbili i gjuhës shqipe"</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>Jepen informacione për jetën dhe veprën e Naim Frashërit, duke u ndalë në veprimtarinë e tij.</p> <p>Njohtohen nxënësit me kulturën e Naimit.</p> <p>Jepen informacione për rolin që luan figura e Naimit në Rilindjen Kombëtare.</p> <p>Bashkë me nxënësit analizohen veprat: "<i>Bagëti e bujqësi</i>" dhe "<i>Historia e Skënderbeut</i>".</p> <p>Komentohet lloji letrar i veprave.</p> <p>Ndalemi në gjuhën e këtyre veprave të Naimit.</p> <p>Jepet informacion për aktivitetin politik të Naim Frashërit dhe vëllezërve të tij dhe ndikimin e tyre në politikën shqiptare.</p> <p>Nxënësit ndahen në grupe dhe secilit grup i jepet nga një pjesë e poemës për ta lexuar dhe komentuar.</p> <p>Dëgjohen komentet e secilit grup dhe jepen shpjegime shtesë, sipas nevojës.</p> <p>Metodat:</p>	<p>Nxënësi /nxënësja mund:</p> <p>2.7.1. të fitojë një pasqyrë mbi rolin e Naimit në kulturën dhe letërsinë shqipe;</p> <p>2.7.2. të numërojë dhe memorojë kontributin e Naimit në më tepër fusha të dijes;</p> <p>2.7.3. të numërojë dhe emërtojë llojet e epikës dhe lirikës që i lëvroi N. Frashëri dhe rëndësinë e tyre në zhvillimin e letërsisë shqiptare;</p> <p>2.7.4. ta analizojë poemën idilike "<i>Bagëti e bujqësi</i>",</p>

	<p>-të identifikojë elementin atdhetar të Naimit;</p> <p>-të analizojë poemat atdhetare të Naimit, <i>"Bagëti e bujqësia"</i> dhe <i>"Historia e Skënderbeut"</i>;</p> <p>-të njohë kontributin e Naimit në arsimimin e popullit;</p> <p>-të i kuptojë vlerat dhe porosinë e veprave të Naimit;</p> <p>-të përcaktojë vendin e Naimit në letërsinë shqipe dhe rolin e tij në afirmimin e letërsisë, kulturës, traditës, folklorit dhe qenies shqiptare në qarqet botërore.</p>		<p>metoda e komunikimit;</p> <p>metoda e demonstrimit;</p> <p>metoda e punës me tekst;</p> <p>metoda e ilustrimit;</p> <p>metoda e krahasimit;</p>	<p>dhe poemën heroike <i>"Historia e Skënderbeut"</i>;</p> <p>2.7.5.të dallojë motivin atdhetar tek <i>"Atdheu"</i> dhe <i>"Shqipëria"</i>;</p> <p>2.7.6.të dijë të vlerësojë gjuhën në poezinë <i>"Gjuha jonë"</i>.</p>
2.8	<p>Nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë:</p> <p>-të përshkruajë vendin e Pashko Vasos në kulturën dhe letërsinë shqipe;</p>	<p>Pashko Vasa– jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet: Burrë shteti</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>Nxënësit njihen me të dhënat jetësore mbi Pashko Vasos dhe kontributin e tij në më shumë sfera të dijes, si: në jetën politike , në jetën kulturore, shkencore, publicistike, në jetën letrare (në fushën e poezisë dhe romanit).</p>	<p>Nxënësi /nxënësja mund:</p> <p>2.8.1.të shpjegojë vendin e Vasos në kulturën shqiptare;</p> <p>2.8.2. t'i memorojë poezinë <i>"Mori Shqypni..;</i></p>

	<p>-të njohë rrethanat shoqërore shqiptare të kohës dhe kontributin e Pashko Vasos në to;</p> <p>-të njohë kontributin e Pashko Vasës në më shumë sfera të dijes, si: në jetën politike, në histori, në internacinalizimin në përmasa ndërkombëtare të çështjes shqiptare;</p> <p>- të njohë memorandumet e Vasos;</p> <p>-të njohë P. Vason dhe romanin e tij <i>"Bardha e Temalit"</i>;</p> <p>-të analizojë poezinë patriotike <i>"Mori Shqypni"</i> të Vasos;</p> <p>-ta kuptojë simbolikën e poezisë të Vasos;</p> <p>-ta njohë veprën romantike të Vasos;</p>	<p>Revolucionar Atdhetar Romanet Lirika Ideologjia Gjuha shkencore, publicistike dhe letrare Folklori kombëtar</p>	<p>Bashkë me nxënësit lexohen dhe analizohen poezia <i>"Mori Shqypni, e mjera Shqypni"</i>, duke u ndalë më shumë në tridimensionalitetin tematik: e kaluara, e tanishmja dhe e ardhmja. Jepen informacione për Vason si revolucionar. Jepen informacione për Vason si romansier, poet, studiues dhe rolin e tij në Rilindjen Kombëtare.</p> <p>Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup përzgjedh një poezi dhe e analizon. Kërkohet nga nxënësit që të shkruajnë një ese për Vason (janë të lirë që vetë të zgjedhin se për cilin aspekt të veprës së Vasos do të shkruajnë).</p> <p>Metodat: metoda e komunikimit; metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit; metoda e krahasimit.</p>	<p>2.8.3. t`i analizojë romanet e P. Vasos <i>"Bardha e Temalit"</i> dhe <i>"Burgimi im"</i>;</p> <p>2.8.4. t`i numërojë dhe shpjegojë simbolet e poezisë me motiv patriotik, të gjejë figurën e krahasimit në vargjet e Vasos;</p> <p>2.8.5. t`i numërojë dhe emërtojë veprat tjera të Vasos;</p> <p>2.8.6. ta përshkruajë kontributin e P. Vasos në çështjen kombëtare.</p>
--	---	--	--	---

	- të njohë tonin kushtrimtar në vargjet e Vasos, moto të Rilindjes Kombëtare.			
2.9	<p>Nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë:</p> <p>-të përshkruajë vendin e Ndre Mjedës në letërsinë shqipe;</p> <p>-t'i numërojë motivet dhe temat kryesore të poezive në veprën "<i>Juvenilia</i>";</p> <p>-t'i memorojë poezitë më të njohura të Ndre Mjedës, "<i>Vaji i bylbylit</i>", "<i>Lissus</i>", "<i>Lirija</i>", "<i>Scodra</i>";</p> <p>-t'i identifikojë veçantitë e poezisë së Ndre Mjedës, karakteristikat e saj gjuhësore dhe artizmin e vargut e të strofës;</p> <p>-të dallojë romantiken dhe realisten në poemën "<i>Andra e jetës</i>".</p>	<p>Ndre Mjeda–jeta dhe vepra</p> <p>Koncepte: "Juvenilia" Motivi patriotik Motivi shoqëror Zë i veçantë në letërsinë shqipe Studiues i gjuhësisë, i folklorit, i gramatikës, i historisë Përkthyes Libra shkollor Romantik-realist</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>Jepen informacione të përgjithshme mbi jetën dhe veprën e Ndre Mjedës. Lexohen poezitë e motiveve të ndryshme dhe nxiten nxënësit të mendojnë rreth preokupimeve kryesore tematike të poezisë së Ndre Mjedës. Lexohen fragmente nga poezia "<i>Vaji i bylbylit</i>", e cila analizohet dhe kërkohet nga nxënësit që të mendojnë se cili është karakteri simbolik në këtë poezi. Lexohen fragmente nga poema "<i>Andra e jetës</i>" dhe nxiten nxënësit që ta shpjegojnë dhe analizojnë këtë poemë, duke përfshirë përmbajtjen dhe formën. Nxiten nxënësit të diskutojnë rreth mënyrës si trajtohet tema patriotike-atdhetare dhe shoqërore në veprimtarinë e Ndre Mjedës. Duke u nisë nga fragmentet e lexuara, nxiten nxënësit të mendojnë rreth karakteristikave gjuhësore të veprave të N. Mjedës.</p> <p>Metodat: metoda e punës me tekst; metoda e komunikimit; metoda e demonstrimit;</p>	<p>Nxënësi /nxënësja mund:</p> <p>2.9.1. ta identifikojë veprën e Ndre Mjedës;</p> <p>2.9.2. të njohë kontributin e Ndre Mjedës në letërsinë shqipe dhe ndikimin që pati poezia e tij te poetët më të rinj;</p> <p>2.9.3. ta njohë raportin e poezisë së Ndre Mjedës me folklorin shqiptar;</p> <p>2.9.4. të njohë veçantitë gjuhësore të veprës së Ndre Mjedës;</p> <p>2.9.5. t'i numërojë e memorojë tituj e poeziv patriotike;</p> <p>2.9.6. ta shpjegojë karakterin simbolik: bilbili i privuar nga liria dhe kafazi privuesi që mban bilbilin nën dhunë;</p>

			metoda e krahasimit.	2.9.7. të analizojë personazhet e poemës "Andra e jetës": Trina, Zoga dhe Lokja.
3.	Realizmi evropian			
3.1	<p>Nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -të identifikojë kohën dhe rrethanat, në të cilat u paraqit realizmi si drejtim letrar, shkollë letrare ose formacion stilistikor; -të dallojë realizmin si metodë letrare (që ka karakter ahistorik) dhe si drejtim letrar (që ka karakter historik); -të dallojë fazat e zhvillimit të realizmit evropian dhe përfaqësuesit kryesor; -të dallojë karakteristikat e realizmit, duke i krahasuar me ato të dejttimeve letrare që i paraprijnë; 	<p>Realizmi ne letërsinë evropiane</p> <p>Konceptet: Realizmi si drejtim letrar, shkollë letrare apo formacion stilistikor Realizmi si metodë letrare Karakteristikat e realizmit.</p>	<p>Veprimtaritë: Nëpërmjet të leximit të fragmenteve nga një vepër romantike dhe një realiste, nxiten nxënësit të mendojnë rreth dallimeve mes tyre. Duke bërë përsëritje mbi kohën dhe rrethanat, që mundësuar lindjen e romantizmit në letërsi, shpjegohet koha dhe rrethanat që mundësuan lindjen e realizmit. Nxiten nxënësit të mendojnë për dallimin mes realizmit si metodë letrare dhe si drejtim letrar (shkollë letrare ose formacion stilistikot). Për t`i orientuar nxënësit, jepet shpjegimi se realizmi si metodë letrare, ashtu si edhe romantizmi, ka karakter ahistorik, pra elemente realiste gjejmë në të gjithë fazat e zhvillimit të letërsisë, kurse si drejtim letrar realizmi ka karakter historik dhe dominon në gjysmën e dytë të shek. XIX, pavarësisht se veprat e para realiste paraqiten që në vitet `30 të shek.XIX. Nxiten nxënësit, në formë të përsëritjes, të përkujtohen në karakteristikat e romantizmit dhe duke folur për një karakteristike të caktuar</p>	<p>Nxënësi /nxënësja mund:</p> <ul style="list-style-type: none"> 3.1.1. të identifikojë kohën dhe rrethanat e dominimit të realizmit si drejtim letrar; 3.1.2. të bëjë dallim mes realizmit si metodë letrare dhe si drejtim letrar; 3.1.3. t`i memorojë karakteristikat kryesore të realizmit evropian; 3.1.4. të bëjë krahasim mes realizmin dhe romantizmin si drejtim letrar; 3.1.5. t`i dallojë dhe t`i emërtojë fazat e zhvillimit të realizmit evropian.

	<p>-të identifikojë gjinitë letrare më të zhvilluara në letërsinë e realizmit;</p> <p>-të dallojë specificitetet e realizmit francez, anglez, amerikan dhe rus.</p>		<p>të romantizmit, p.sh. qëndrimi ndaj realitetit, ndërtimi i personazheve, preokupimet tematike etj., shpjegohen po ajo karakteristikë në realizëm.</p> <p>Duke u ndalë në emrat e përfaqësuesve me të njohur të realizmit evropian, shpjegohen fazat e zhvillimit të realizmit dhe karakteristikat e secilës fazë.</p> <p>Duke përmendur reprezentë të caktuar të letërsisë franceze, angleze, amerikane e ruse, mundohemi të shpjegojmë se, sikurse gjithë drejtimet tjera letrare, ashtu edhe realizmi, në mjedise të caktuara, karakterizohet me specificitete të veta.</p> <p>Jepen shpjegime rreth gjinive dhe llojeve letrare më të zhvilluara në letërsinë e realizmit evropian.</p> <p>Metodat: metoda e punës me tekst; metoda e demonstrimit; metoda e komunikimit; metoda analitike; metoda e krahasimit.</p>	
3.2	<p>Nxënësi /nxënësja do të jetë i aftë: -t`i njohë rrethanat e kohës, në të cilën u krijua vepra</p>	<p>Honore de Balzak– jeta dhe vepra</p>	<p>Veprimtaritë: Jepen informacione për rrugën jetësore dhe për veprimtarinë letrare të Honore de Balzakit. Në pika të shkurta informohen nxënësit me preokupimet tematike të prozës së Balzakit.</p>	<p>Nxënësi /nxënësja mund: 3.2.1. ta vlerësojë kontributin e Balzakit në zhvillimin e letërsisë botërore, veçmas të prozës;</p>

	<p>letrare e Honore de Balzakut;</p> <p>-të identifikojë raportin e veprës së Balzakut me jetën provinciale, politike, ushtarake dhe fshatare;</p> <p>-të identifikojë studimet filozofike dhe studimet analitike të Balzakut ;</p> <p>-të numërojë dhe emërtojë preokupimet tematike të veprave të Balzakut;</p> <p>-të analizojë veprë <i>"Xha Gorio"</i>;</p> <p>-të vërtetojë arsyen pse ky roman zë vend të veçantë në <i>"Komedinë njerëzore"</i>;</p> <p>-të fitojë një pasqyrë të përgjithshme për Balzakun si romancier;</p> <p>-të dallojë tiparet gjuhësore dhe stilistike të prozës së Balzakut.</p>	<p>Konceptet: Proza e shkurtër Proza e gjatë Raporti me folklorin Raporti me filozofinë Proza e gjatë –novela, romani Babai i romanit, <i>"Komedia njerëzore"</i> <i>"Xha Gorio"</i> Temat Personazhet</p>	<p>Jepen informacione për llojet e prozave që i trajtoi Balzaku, duke u ndalë veçmas te tregimet dhe preokupimet tematike të tyre. Jepen informacione për <i>"Komedinë njerëzore"</i>, ndarjen e saj në tri seri.</p> <p>Lexohet fragmenti i dhënë nga <i>"Xha Gorio"</i>; Nxiten nxënësit të mendojnë rreth mesazhit që jep autori në këtë vepër dhe diskutohet për marrëdhënien personazh-mjedis.</p> <p>Nxiten nxënësit të bëjnë analizë psikologjike të personazhit kryesor të romanit.</p> <p>Nxiten nxënësit që, duke u mbështetur në fragmentin e dhënë, të diskutojnë marrëdhëniet e Gorios me të bijat.</p> <p>Nxënësve u jepet për detyrë të krahasojnë Gorion me mbretin Lir të Shekspirit.</p> <p>Metodat: metoda e punës me tekst; metoda e demonstrimit; metoda e komunikimit; metoda analitike; metoda e krahasimit.</p>	<p>3.2.2. të shpjegojë preokupimet tematike të prozës së Balzakut;</p> <p>3.2.3. të identifikojë veçoritë gjuhësore e stilistike të romanit të Balzakut;</p> <p>3.2.4. të shpjegojë <i>"Xha Gorion"</i>;</p> <p>3.2.5. të analizojë marrëdhëniet e personazheve në veprën e Balzakut;</p> <p>3.2.6. të identifikojë raportin e <i>"Komedisë njerëzore"</i> me <i>"Komedinë hyjnore"</i> të Dante Aligierit.</p>
--	--	---	---	---

4.	Realizmi në letërsinë shqiptare			
4.1	<p>Nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -të identifikojë kohën dhe rrethanat, në të cilat u paraqit realizmi shqiptar si drejtim letrar, shkollë letrare ose formacion stilistikor; -të dallojë realizmin si metodë letrare (që ka karakter ahistorik) dhe si drejtim letrar (që ka karakter historik); -të dallojë fazat e zhvillimit të realizmit shqiptar dhe përfaqësuesit kryesor; -të dallojë karakteristikat e realizmit, duke i krahasuar me ato të dejttimeve letrare që i paraprijnë; -të identifikojë gjinitë letrare më të zhvilluara në letërsinë e realizmit shqiptar. 	<p>Realizmi në letërsinë shqiptare</p> <p>Konceptet: Realizmi si drejtim letrar, shkollë letrare apo formacion stilistikor Realizmi si metodë letrare Karakteristikat e realizmit.</p>	<p>Veprimtaritë: Nëpërmjet të leximit të fragmenteve nga një vepër romantike dhe një realiste, nxiten nxënësit të mendojnë rreth dallimeve mes tyre. Duke bërë përsëritje mbi kohën dhe rrethanat, që mundësuar lindjen e romantizmit shqiptar, shpjegohet koha dhe rrethanat që mundësuan lindjen e realizmit në letërsinë shqiptare. Nxiten nxënësit të mendojnë për dallimet mes realizmit shqiptar dhe atij evropian. Nxiten nxënësit, në formë të përsëritjes, të përkujtohen në karakteristikat e romantizmit për t`i ndërlidhur ato me realizmin. Duke u ndalë në emrat e përfaqësuesve me të njohur të realizmit shqiptar, shpjegohen fazat e zhvillimit të realizmit shqiptar dhe karakteristikat e tij.</p> <p>Metodat: metoda e punës me tekst; metoda e demonstrimit; metoda e komunikimit; metoda analitike; metoda e krahasimit.</p>	<p>Nxënësi /nxënësja mund:</p> <ul style="list-style-type: none"> 4.1.1. të identifikojë kohën dhe rrethanat e dominimit të realizmit si drejtim letrar; 4.1.2. të bëjë dallim mes realizmit shqiptar dhe atij evropian; 4.1.3. t`i memorojë karakteristikat kryesore të realizmit shqiptar; 4.1.4. të bëjë krahasim mes realizmin dhe romantizmin si drejtim letrar; 4.1.5. t`i dallojë dhe t`i emërtojë fazat e zhvillimit të realizmit shqiptar.

<p>4.2</p>	<p>Nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë: -të njohë rrethanat në të cilat u krijua vepra e Çajupit;</p> <p>-të dallojë veçantitë e veprës së Çajupit;</p> <p>-të analizojë komedinë “Katërmëdhjetë vjeç dhëndër” dhe rolin që luan ajo në letërsinë shqipe të kësaj periudhe;</p> <p>-të analizojë veprën “Baba Tomorri”;</p> <p>-të numërojë veprat tjera të Çajupit dhe të fitojë një pasqyrë mbi vendin e tyre në letërsinë shqipe;</p> <p>- të dallojë gjinitë, format dhe tematikën e veprimtarisë së Çajupit;</p> <p>-nëpërmjet veprës së Çajupit, të fitojë një pasqyrë mbi rrugën e zhvillimit të realizmit shqiptar.</p>	<p>Anton Zako-Çajupi – jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet: Pasardhës i Naimit Dramaturgji Komedi Lirikë shoqërore Koncept erotik Elegji Diskriminimi i gruas Gjuhë poetike</p>	<p>Veprimtaritë: Nxënësit njohtohen me të dhënat jetësore mbi Çajupin dhe veprimtarinë e tij letrare. Nxiten nxënësit që t`i shprehin mendimet e veta rreth përmbledhjes “Baba Tomorri” dhe rolit që luan ajo në letërsinë shqipe të kohës. Nxiten nxënësit që t`i shprehin mendimet e veta rreth komedisë “Katërmëdhjetë vjeç dhëndër”.</p> <p>Analizohen personazhet e komedisë dhe nxiten nxënësit të mendojnë rreth temës dhe mesazhit që përcillet nëpërmjet të kësaj vepre. Lexohet fragmenti i dhënë dhe kërkohet që nxënësit ta analizojnë.</p> <p>Nxënësit ndahen në grupe dhe kërkohet që secili grup, të përzgjedh dhe të analizojë njërin prej këtyre dy personazheve: gruan ose burrin në shoqërinë shqiptare, po të njëjtat t`i bëjë nëpërmjet Tanës dhe Vangjelit ose Marigonës dhe Gjinit;</p> <p>Secili grup i shpreh opinionet e veta dhe hapet diskutim.</p> <p>Metodat: metoda e komunikimit; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit; metoda e krahasimit.</p>	<p>Nxënësi /nxënësja mund: 4.2.1. të fitojë një pasqyrë mbi jetën dhe veprën e A.Z.Çajupit;</p> <p>4.2.2. ta shpjegojë subjektin e komedisë “Katërmëdhjetë vjeç dhëndër” dhe të analizojë personazhet kryesore;</p> <p>4.2.3. ta kuptojë rolin që luan gruaja në komedi dhe në shoqërinë e kohës;</p> <p>4.2.4. të analizojë lirikën e Çajupit në veprën “Baba Tomorri”;</p> <p>4.2.5. nëpërmjet të analizës së fragmentit të dhënë, të njihet me realitetin dhe mentalitetin shqiptar të kohës;</p> <p>4.2.6. ta kuptojë vendin që zë Çajupi në letërsinë shqiptare.</p>
------------	---	---	---	---

<p>4.3</p>	<p>Nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë: -të fitojë një pasqyrë të përgjithshme mbi jetën dhe veprën e Asdrenit;</p> <p>-të dallojë fazat e krijimtarisë letrare të Asdrenit;</p> <p>-t`i numërojë preokupimet tematike të poezisë së Asdrenit në faza të ndryshme;</p> <p>-ta analizojë përmbledhjet poetike "Rreze dielli", "Ëndrra e lotë" dhe "Psallme murgu";</p> <p>-t`i analizojë poezitë atdhetare- shoqërore, "Lulekuqja", "Mall vëllazërie", "Letër prej katundit tem";</p> <p>-t`i analizojë poezitë me motiv erotik, "Ti me sytë e zi", "Ballada e bariut";</p>	<p>A. S. Drenova– jeta dhe vepra</p> <p>Konceptet: Lirikë Motive atdhetare- shoqërore Motivi erotik Motivi peizazhist Motivi meditativ Strofa dhe vargje të ndryshme.</p>	<p>Veprimtaritë: Jepen informacione të përgjithshme për jetën dhe veprën e Asdrenit dhe vendin që zë ai në letërsinë shqipe. Nxiten nxënësit ta analizojnë përmbledhjet poetike "Rreze dielli", "Ëndrra e lotë" dhe "Psallme murgu", duke u ndalë në motivet dhe temat e cikleve të caktuara. Lexohen dhe analizohen poezitë më të njohura të këtyre përmbledhjeve. Analizohet veçmas "Betimi mbi flamur". Diskutohet rreth elementit politik dhe social të poezisë së Asdrenit. Nxiten nxënësit të diskutojnë rreth rolit që luan poezia e Asdrenit në zhvillimin e realizmit të letërsisë shqipe. Meqë nxënësit i kanë të njohur veprat e Çajupit dhe Naimit, nxiten të bëjnë krahasim mes poezive atdhetare-shoqërore të Asdrenit me ato të Çajupit dhe Naimit. -kërkohet nga nxënësit që të shkruajnë nga një ese, të motivuar nga poezia e Asdrenit.</p> <p>Metodat: metoda e komunikimit; metoda e demonstrimit; metoda e punës me tekst; metoda e ilustrimit; metoda e krahasimit.</p>	<p>Nxënësi /nxënësja mund: 4.3.1. të fitojë një pasqyrë mbi rolin që luan dhe vendin që zë poezia e Asdrenit në letërsinë shqipe;</p> <p>4.3.2. t`i numërojë dhe emërtojë veprat e Asdrenit;</p> <p>4.3.3. t`i identifikojë motivet dhe temat kryesore të poezisë së Asdrenit;</p> <p>4.3.4. ta analizojë përmbledhjen "Rreze dielli", "Ëndrra e lotë" dhe "Psallme murgu" gjegjësisht ciklet poetike të tyre;</p> <p>4.3.5. t`i analizojë poezitë më të njohura të këtyre përmbledhjeve, sidomos poezitë që janë dhënë në libër;</p> <p>4.3.6. t`i dallojë tiparet gjuhësore dhe stilistike të poezisë së Asdrenit;</p>
------------	--	---	--	--

	<p>-t`i analizojë poezitë me motiv peizazhist, "Vjeshta", "Perëndim dielli në verë";</p> <p>-t`i analizojë poezitë me motiv meditativ, "Lumtësia", "Një ëndërr", "Vërtetësia e gjëravet";</p> <p>-t`i krahasojë poezitë e Asdrenit me ato të Naimit dhe Çajupit;</p> <p>-ta kuptojë vendin e Asdrenit në letërsinë shqiptare.</p>			
5.	Edukimi mediatik			
5.1	<p>Nxënësi /nxënësja do të jetë i/e aftë:</p> <p>- të ndjekë, të analizojë e të komentojë informacionet e medias;</p> <p>- bën hulumtime për nëpër hapësirën mediatike/medie dhe prezanton, komenton e interpreton të dhënat si dhe analizon faktet për to.</p>	<p>Media – si formë për transmetimin e informacioneve</p> <p>Parimet e edukimit mediatik: qasja në medie, objektiviteti gjatë ndjekjes së informacioneve dhe analiza e tyre, vlerësimi – shprehja e mendimit</p>	<p>Veprimtaritë:</p> <p>Hulumtimi i institucioneve mediatike prej grupesh të ndryshme të formuara në marrëveshje me nxënësit (nxënësit porositen që të mbanë shënime për të gjitha fazat e hulumtimit: tema dhe qëllimi i tij, metodologjia dhe instrumentet, analiza, përfundimet dhe rekomandimet).</p> <p>Organizimi i debatit/debateve rreth rolit/roleve të rrjeteve sociale në jetën bashkëkohore; debatimi për parimet në rrjetet sociale –</p>	<p>Nxënësi mund:</p> <p>5.1.1: të ndjekë medien dhe të diskutojë në mënyrë objektive rreth informacioneve që ndjek;</p> <p>5.1.2: të bëjë hulumtimin dhe t`i analizojë të dhënat nga hulumtimi i medias për të vlerësuar objektivitetin e saj;</p>

		<p>kritik, komunikimi me medien.</p> <p>Rrjetet sociale - rolet e rrjeteve sociale.</p> <p>Rregullat për rrjetet sociale (formale dhe ligjore).</p>	<p>rregulla të vendosura nga vetë rrjeti të cilat duhet/detyrohen t'i zbatojnë shfrytëzuesit e tyre; tërësia e rregullave ligjore – a ka të tillë dhe si realizohet ajo në hapësirën eterike sa u përket përmbajtjeve që paraqiten nëpër këto rrjete.</p> <p>Metodat: monolog-dialog; metoda e demonstrimit; analiza, sinteza; metoda e zgjidhjes së problemit; metoda e krahasimit.</p>	<p>5.1.3: t'i prezantojë e t'i interpretojë të dhënat nga hulumtimi në medie me anë të raportit;</p> <p>5.1.4: të vlerësojë informacionet e të dhënat dhe të shprehë qëndrimin e vet lidhur me to.</p>
--	--	---	--	--

<p>Notimi i të arriturave të nxënësve</p>	<p>Notimi është një proces i vazhdueshëm dhe ka për qëllim të siguron informacione gjithpërfshirëse për të arrituarit e nxënësve dhe njëkohësisht t'i përmirëson të njëjtat, gjegjësisht, përparimi dhe notimi i nxënësve i cili monitorohet në vazhdimësi dhe kryhet në kontinuitet gjatë mësimin dhe nënkupton mbledhjen e rregullt të informacioneve të cilat dokumentohen.</p> <p>Notimi i nxënësve ka për qëllim që tua tregon gjendjen reale të njohurive të tyre dhe t'u jep kahje për përpërkullimin permanent të mëturjeshtëm. Kriteret për notim arsimtari ua sqaron nxënësve dhe në mënyrë konsistente iu pëmbahet të njëjtave gjatë gjithë vitit shkollor. Instrumentet të cilat kanë të bëjnë me pjesën gojore të notimit dhe vlerësimin të nxënësve mund të jenë me përgjigje të parashtruara nga ana e arsimtarit, pyetje të destinuara para përpunimit të veprës, lekturës, si dhe përmbajtjeve nga gjuha, prezantime gojore të temave të caktuara, sjelljen e mendimeve dhe qëndrimeve në lidhje me</p>
--	--

	<p>parashtrimin e pyetjeve problemore në vepër dhe lektyre, diskutim për veprat letrare në kontekst shoqëror, historik dhe letrar, detyra shtëpie, aktivite dhe angazhim në orë.</p> <p>Instrumentet për notim me shkrim lidhen me punime me shkrim, me teste objektive të njohurive, të shkathësive, veçanarisht me teste dhe ese të pavarura nëpërmjet të cilave nxënësit do ta zbatojnë të mësuarën përmes shprehjes individuale. Nxënësit për të arriturat e tyre marrin notë numerike.</p>
Literaturë dhe burime të tjera	Tekste mësimore dhe doracak të lejuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe burime tjera të të mësuarit.
Почеток на имплементација на наставна програма Fillimi i implementimit të programit mësimor	Учебна 2021/2022 година Viti shkollor 2021/2022
Институција/ носител на програмата Institucioni/bartësi i programit	Биро за развој на образованието Буроја e Zhvillimit të Arsimit
Потпис и датум на донесување на наставната програма Nënshkrimi dhe data e miratimit të programit mësimor	<p>Бр./nr. 13-10358/3</p> <p>7.10.2024 година</p> <p style="text-align: right;">Министер за образование и наука, Ministër i Arsimit dhe Shkencës,</p> <p style="text-align: right;">Проф. д-р Весна Јаневска, с.р.</p> <p style="text-align: right;">_____</p>
Датум на ревизија/Data e revizionit	

